



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 23, datë 26.11.2020

PËR

“KALIMIN E TË DREJTAVE DHE DETYRIMEVE TË CAKTUARA NË AKTET RREGULLATORE TË NXJERRA NGA AKEP SI DHE AUTORIZIMET E PËRGJITHSHME DHE INDIVIDUALE TË SIPËRMARRËSIT ABCOM SH.P.K TEK SIPËRMARRËSI VODAFONE ALBANIA SH.A”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi	Frashëri	Kryetar
Znj.	Edlira	Dvorani	Anëtar
Znj.	Ketrin	Topçiu	Anëtar
Znj.	Xhoana	Lilaj	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 26/11/2020, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, si dhe Ligjin Nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

- **Kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP si dhe Autorizimet e Përgjithshme dhe Individuale të sipërmarrësit Abcom sh.p.k tek sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a.**

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 13 e vijues, 74, 83, 114 dhe 115 të Ligjit nr.9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**Ligji nr.9918/2008**);
2. Ligji nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në RSH”, (**Ligji nr.44/2015**);
3. Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar ;
4. Rregullore nr.47, datë 26.10.2017, “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm” (**Rregullore nr.47/2017**);
5. Rregullore Nr. 30, datë 05.12.2013 “Për dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave”.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresat e sipërmarrësve “Abcom” sh.p.k dhe “Vodafone Albania” sh.a;
2. Projekt-Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;
3. Relacionin shoqërues të Projekt-Vendimit, të paraqitur nga Drejtoria e Autorizimeve dhe Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullore;

si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen dhe bazës ligjore të lartpërmendur,

V Ë R E N:

1. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) ka administruar shkresën e sipërmarrësit Abcom sh.p.k nr. 2327 prot. i AKEP, datë 06.11.2019 me lëndë: *“Njoftim për ndryshimet në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Abcom” sh.p.k”, me anën e së cilës sipërmarrësi “Abcom” sh.p.k njofton AKEP që në datën 15.10.2019 është nënshkruar kontrata për shitjen e kuotës së kapitalit themeltar të shoqërisë, në masën 100%, nga ortaku ekzistues “American Broadband B.V” tek shoqëria “Vodafone Albania” sh.a dhe ky ndryshim do të bëhet efektiv me miratimin e transaksionit nga Autoriteti i Konkurrencës.*
2. Pranë AKEP me shkresën nr. 624/3 prot. datë 03.12.2019 (nr. 2327/1 prot. i AKEP datë 05.12.2019), është paraqitur edhe një kërkesë për informacion nga Autoriteti i Konkurrencës. AKEP i ka kthyer përgjigje Autoritetin të Konkurrencës me shkresën nr. 2327/2 prot. datë 20.01.2020.
3. Me shkresën nr. 2327/3 prot. datë 03.02.2020, AKEP ka sqaruar “Abcom” shpk që pasi të jenë pajisur me miratimet nga Autoritetet përkatëse që shqyrtojnë këtë veprim, dhe reflektimin e ndryshimeve në ekstraktin e shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), bazuar në pikën 4, të nenit 14, të Ligjit 9918/2008 i ndryshuar, duhet të njoftohet zyrtarisht AKEP.
4. Autoriteti i Konkurrencës me vendimin nr. 676 datë 07.02.2020, ka vendosur të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfuturit të kontrollit të shoqërisë ABCOM sh.p.k nga shoqëria Vodafone Albania sh.a me kushte dhe detyrime.
5. AKEP me shkresën nr. 2327 prot. datë 10.1.2020, ka sqaruar Autoritetin e Konkurrencës se detyrimet e sipërcituara, në bazë të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 *“Për mbrojtjen e konkurrencës”* janë në objektin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës. Vendimmarja e AKEP për miratimin e kalimit të të drejtave dhe detyrimeve nga sipërmarrësi “Abcom” shpk tek sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a është në zbatim të Ligjit 9918/2008, i ndryshuar, akteve rregullore të AKEP dhe Vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP, në fuqi.
6. Në vijim të procesit, në datën 03.11.2020 shoqëria “Abcom” sh.p.k ka depozituar pranë AKEP kërkesën nr. 2327/4 prot. datë 03.11.2020 me lëndë: *“Kërkesë për miratimin paraprak të Bashkimit me Përthithje të Shoqërisë “Abcom” sh.p.k nga Shoqëria Vodafone Albania sh.a dhe kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatorë të nxjerra nga AKEP si dhe autorizimet e përgjithshme dhe ato individuale të “Abcom” sh.p.k tek subjekti përfundimtar përthithës “Vodafone Albania” sh.a”.*

7. Sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a me shkresën nr. 2327/5 prot. datë 03.11.2020 me lëndë: *“Kërkesë për miratimin paraprak të Bashkimit me Përthithje të Shoqërisë “Abcom” sh.p.k nga Shoqëria Vodafone Albania sh.a dhe kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatorë të nxjerra nga AKEP si dhe autorizimet e përgjithshme dhe ato individuale të “Abcom” sh.p.k tek subjekti përfundimtar përthithës “Vodafone Albania” sh.a., në vijim të kërkesës së “Abcom” sh.p.k. datë 03.11.2020, nr.prot 2327/4.”*, ka njoftuar AKEP se “Vodafone Albania” sh.a, si subjekti përthithës, në përputhje me dakortësinë e palëve, sipas Marrëveshjes së Bashkimit, është dakort me kërkesën e Abcom shpk për miratimin paraprak të Bashkimit me Përthithje të Shoqërisë “Abcom” sh.p.k nga shoqëria “Vodafone Albania” sh.a. dhe kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP si dhe autorizimet e përgjithshme dhe ato individuale të “Abcom” sh.p.k (si mbajtës i autorizimeve) tek subjekti përfundimtar përthithës “Vodafone Albania” sh.a”.
8. Aktualisht ky transaksion tregtar i bashkimit me përthithje është materializuar, duke u bërë tashmë fakt juridik i mbështetur në dispozitat normative të ligjit nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, (Kreu I, neni 216 e vijues i tij), AKEP si organi rregullator kompetent, ndër të tjera, për kryerjen e regjistrimit të sipërmarrësve të rrjeteve dhe komunikimeve elektronike dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike në përfundim të procesit të njoftimit të tyre, si organi që lëshon autorizimet individuale për përdorimin e frekuencave, numrave dhe serive numerike, si autoriteti rregullator që përcakton sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse, ka detyrimin ligjor të realizojë kalimin e të gjithë të drejtave dhe detyrimeve, të caktuara në ushtrimin e veprimtarisë së tij rregullatore, nga sipërmarrësi “Abcom” sh.p.k tek sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a.
9. AKEP, gjatë ushtrimit të pushtetit diskrecional dhe vendimtar ka arsyetuar në mënyrë ligjore dhe administrative të mbështetur në ligj dhe fakte Vendimet e Këshillit Drejtues prej të cilave burojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e këtyre dy sipërmarrësve në akte të veçanta rregullatore, si dhe në Autorizimet e Përgjithshme dhe Individuale të tyre. Këto të drejta dhe detyrime duhet të transferohen mbështetur në dispozitat ligjore (neni 74, i Ligjit 9918/2008, i ndryshuar), kur për kalimin e tyre ka një interes të shprehur në AKEP nga të dy sipërmarrësit “Abcom” sh.p.k dhe “Vodafone Albania” sh.a.

Në mënyrë që të garantohet përdorimi i rregullt, i sigurt dhe eficient, i spektrit të frekuencave, numrave dhe serive numerike, AKEP do të miratojë kalimin e këtyre të drejtave dhe detyrimeve të sipërmarrësit “Abcom” sh.p.k tek sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a, të rregulluara në aktet përkatëse të nxjerra individualisht nga AKEP, sipas lidhjeve që do t’i bashkëngjiten këtij vendimi.

10. Subjekti “Abcom” shpk mbart detyrime rregullatore të përcaktuara pas procesit të analizës së tregut në telefoninë fikse të vitit 2018, vetëm për tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjete publike telefonike individuale të ofruara nga vendndodhje fikse.

Detyrimet e vendosura për FNT (për të gjithë operatorët fiks, përfshirë “Abcom” shpk), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 24, datë 30.03.2018 *“Për përcaktimin e sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”* dhe Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 77, datë 01.10.2018 *“Për rregullimin e tarifave të sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”*, janë:

- a. Operatorët duhet të publikojnë tarifat e terminimit në rrjetet tyre për thirrjet kombëtare.
 - b. Detyrimet e vendosura për FNT (për të gjithë operatorët fikse) janë vetëm për terminimin për thirrjet kombëtare dhe përfshijnë:
 1. Detyrimi i mosdiskriminimit;
 2. Detyrimi i transparencës;
 3. Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit;
 4. Detyrimi për kontroll të tarifave dhe orientim në kosto.
11. Sipërmarrësi “Abcom” sh.p.k është pajisur nga AKEP me 3 Autorizime Individuale për përdorim frekuencash në 6 lidhje fikse, me afate vlefshmërie 31.12.2020, si më poshtë:
- a) Nr. AKEP-2018-LF-000487, nr. AKEP-2018-LF-000490 dhe nr. AKEP-2018-LF-000491.
 - b) Nr. AKEP-2018-LF-000550 dhe nr. AKEP-2018-LF-000551.
 - c) Nr. AKEP-2019-LF-001284).
12. Sipërmarrësi “Abcom” sh.p.k është pajisur nga AKEP me Autorizime Individuale për përdorim numeracionesh, si më poshtë:
- a) Autorizim Individual nr. 536 prot. datë 26.01.2009, caktim seri numerike dhe një kod të shërbimit të thirrjes me kartë të parapaguar.
 - b) Autorizim Individual nr. 3169 prot. datë 04.09.2009, caktim seri numerike.
 - c) Autorizim Individual nr. 4274 prot. datë 06.11.2009, caktim seri numerike.
 - d) Autorizim Individual nr. 906/5 prot. datë 13.07.2011, caktim seri numerike.
 - e) Autorizim Individual nr. 906/6 prot. datë 06.07.2011, caktim kod SMS-VAS.
 - f) Autorizim Individual nr. 1074/3 prot. datë 19.06.2012, caktim kod ISPC.
 - g) Autorizim Individual nr. 551/3 prot. datë 15.05.2012, caktim seri numerike.
 - h) Autorizim Individual nr. 908/3 prot. datë 27.06.2013, caktim seri numerike.
 - i) Autorizim Individual nr. 1700/3 prot. datë 12.11.2013, caktim seri numerike.
 - j) Autorizim Individual nr. 890/1 prot. datë 17.05.2016, caktim kod NSPC.
13. Në lidhje me kontratën e pajtimit, “Vodafone Albania” sh.a, pas përfundimit të bashkimit me përrthithje me “Abcom” shpk, duhet të zbatojë përcaktimet e pikës 5, të nenit 99, të Ligjit 9918/2008, i ndryshuar.
14. Sipërmarrësit “Abcom” shpk dhe “Vodafone Albania” sh.a, nuk rezultojnë debitorë në AKEP dhe nuk kanë detyra të papërbushura nga inspektimet e kryera nga AKEP.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1, neni 114 dhe pikës 1 të nenit 115 të Ligjit nr.9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, K. Pr. A, dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, duke marrë në konsideratë rëndësinë që paraqet miratimi i këtij vendimi, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë kalimin e të drejtave të Autorizimeve Individuale, për përdorimin e frekuencave në 6 lidhje fikse radio, nga sipërmarrësi “Abcom” sh.p.k. tek sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a, sipas Aneksit nr. 1, bashkëlidhur.
2. Të miratojë kalimin e të drejtave të Autorizimeve Individuale, për përdorimin e numeracioneve, nga sipërmarrësi “Abcom” sh.p.k tek sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a, sipas Aneksit nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Të miratojë kalimin e detyrimeve të vendosura për FNT (Fuqi të Ndjeshme në Treg), ndaj sipërmarrësit “Abcom” sh.p.k tek sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a, në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 24, datë 30.03.2018 *“Për përcaktimin e sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”* dhe Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 77, datë 01.10.2018 *“Për rregullimin e tarifave të sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”*.
4. Të miratojë kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara sipërmarrësit “Abcom” sh.p.k tek sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a, në çdo akt tjetër të AKEP dhe miratimin e zëvendësimit të emrit Abcom sh.p.k me Vodafone Albania sh.a, në çdo dokument tjetër të miratuar me aktet respektive të AKEP.
5. Në lidhje me kontratën e pajtimit, sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a, duhet të zbatojë përcaktimet e pikës 5, të nenit 99, të Ligjit 9918/2008 i ndryshuar, pas përfundimit të bashkimit me përthithje me sipërmarrësin “Abcom” shpk.
6. Ky vendim hyn në fuqi në përfundim të procesit të bashkimit me përthithje dhe pas pasqyrimin të ndryshimeve përkatëse të ekstrakteve të shoqërive “Abcom” shpk dhe “Vodafone Albania” sh.a, në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).
7. Ngarkohen Drejtoria e Autorizimeve, Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore dhe Drejtoria Teknike, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim publikohet në faqen e internetit të AKEP, www.akep.al.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Tomi Frashëri	Edlira Dvorani	Ketrin TOPÇIU	Xhoana LILAJ